



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËTOR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE



Kontrolli i Lartë i Shtetit  
Albanian Supreme Audit Institution



ZKA


ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# AUDITIMI I PËRBASHKËT RAJONAL I PERFORMANCËS

BARAZIA GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE  
NGA ZONAT RURALE NËPËRMJET  
PËRFSHIRJES SË TYRE NË TREGUN E PUNËS



Foto: UN Women



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



|   | MAQEDONIA<br>E VERIUT | KOSOVA*              | SHQIPËRIA            | TOTAL     |
|---|-----------------------|----------------------|----------------------|-----------|
|  Takime të organizuara                               | 2                     | 1                    | 2                    | 5         |
|  Subjektet e nivelit qendror të përfshira me auditim | 7                     | 3                    | 1                    | 11        |
|  Subjektet e nivelit lokal të përfshira me auditim   | 0                     | 0                    | 13                   | 13        |
|  Subjekte të audituara                               | 7                     | 3                    | 14                   | 24        |
|  Ligje   | 1                     | 3                    | 3                    | 7         |
|  Strategji   | 3                     | 1                    | 3                    | 7         |
|  Programe  | 6                     | 5                    | 5                    | 16        |
|  Periudha e auditimit                              | 2019-2023             | 2019-2023            | 2019-2023            | 2019-2023 |
|  Qasja e auditimit (orientimi i qasjes)            | Rezultat i sistemit   | Rezultat i problemit | Rezultat i problemit |           |
|  Qëllimi i auditimit                               | 1                     | 1                    | 1                    | 1         |
|  Fushat e auditimit                                | 3                     | 3                    | 3                    | 3         |
|  Gjetjet e auditimit                               | 22                    | 9                    | 10                   | 41        |
|  Rekomandimet e auditimit                          | 25                    | 10                   | 11                   | 46        |
|  Konkluzioni i auditimit                           | 1                     | 11                   | 11                   | 23        |

\*Referencat ndaj Kosovës do të kuptohen se janë në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB -së (1999). Për Bashkimin Evropian, ky përcaktim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të KS të OKB -së dhe Opinionin e GjND -së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.



Foto: Freepik

## HYRJJE

Pabarazia gjinore veçanërisht është e theksuar në zonat rurale. Gratë nga zonat rurale ballafaqohen me më shumë kufizime se sa burrat në qasjen në burimet kryesore të prodhimit, të drejtat pronësore, tokën, pajisjet, si dhe financimin. Ato përballen me diskriminim në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës dhe kompensimin, gjegjësisht pagën për angazhimin e tyre në punë, punët e papaguara të shtëpisë, shkallën e ulët të përfshirjes në marrjen e vendimeve në familje, etj.

Gratë rurale përballen me sfida të shumta, megjithatë ato mbesin forca shtytëse në prodhimin e ushqimit, ruajtjen e traditës, luftën kundër ndryshimeve klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Reduktimi i pabarazisë ndërmjet zonave urbane dhe rurale, si dhe ulja e pabarazisë gjinore duke krijuar kushte për qasje të barabartë në të drejta, mbrojtje nga diskriminimi, avancimi profesional dhe stabiliteti ekonomik i grave në zonat rurale janë vetëm disa nga prioritetet e identifikuara që duhen arritur për të siguruar një jetë më të mirë për gratë në zonat rurale.

Institucionet publike duhet të forcojnë përkushtimin e tyre për të eliminuar diskriminimin dhe për të siguruar qasje në të drejta të barabarta për gratë në zonat rurale.

Gratë nga zonat rurale, duke përfshirë edhe gratë e përfshira në bujqësi, duhet të kenë shanse të barabarta për qasje në mundësitë për punësime formale dhe ndërmarrësi, së bashku me mundësitë për të harmonizuar jetën e punës me përgjegjësitë familjare.

Gratë rurale kanë përgjegjësi të konsiderueshme për prodhimin e ushqimit me theks të veçantë në ushqimin organik, mbijetesën e gjeneratave të ardhshme dhe mjediset rurale, dhe vazhdon t'u mohohet mbështetja nga palët e interesuara në shoqëri.



Është koha për të njohur kontributin e tyre të rëndësishëm për familjen, komunitetin dhe vendin dhe për t'u siguruar që ato të mbështeten dhe të mbrohen si anëtarë të barabartë të shoqërisë. Fuqizimi i tyre social dhe ekonomik, do të krijojë mirëqenia sociale, zhvillim ekonomik, cilësi më të mirë të jetës në zonat rurale dhe komunitete të qëndrueshme.

Barazia gjinore është një nga aspektet kyçe për sigurimin e prosperitetit të të gjithë shoqërisë. Ajo është angazhimi i secilit vend që rrjedh nga Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, miratuar në shtator të vitit 2015 në Samitin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm. Agjenda 2030 identifikon 17 qëllime dhe 169 nën-qëllime që duhet të arrihen deri në vitin 2030 nga të gjitha vendet në botë. Edhe pse barazia gjinore trajtohet si një çështje horizontale që duhet të adresohet gjatë realizimit të qëllimeve në përgjithësi, një objektivë e veçantë e qëllimeve strategjike globale 5 është e paraparë ekskluzivisht për "barazinë gjinore". Ky qëllim synon fuqizimin e grave dhe vajzave dhe realizimin e potencialit të tyre të plotë, i cili nënkupton në mënyrë të pashmangshme eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të bazuar në gjini dhe dhunën me bazë gjinore. Për më tepër, QZHQ 5 synon të mundësoj promovimin e shëndetit seksual dhe riprodhues të grave dhe vajzave, njohjen e punës së papaguar shtëpiake dhe qasjen e barabartë në burime, si dhe pjesëmarrjen e barabartë me burrat në jetën politike, ekonomike dhe publike.

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe rolin e grave rurale në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të vendit, institucionet supreme të auditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës kryen së bashku një auditim bashkëpunues të performancës. Enti Shtetëror i Auditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut është koordinator i auditimit në përputhje me aktivitetet e parapara në marrëveshjen e nënshkruar. Ky auditim është kryer me mbështetjen e Entitetit të Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave - "UN Women".

**Qëllimi i auditimit** ishte të përcaktohej nëse ekzistojnë masa dhe politika për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës.

Institucionet supreme të auditimit përgatitën raporte kombëtare të auditimit me përmbledhje të shkurtra, në të cilat janë përcaktuar gjetjet kryesore, rekomandimet dhe konkluzionet për secilin vend.

# ENTI SHKETËTOR I STATISTIKËS I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË VERIORE


Numri i banorëve në fshatrat e Republikës së Maqedonisë së Veriut është në rënie. Shpopullimi dhe mundësitë e kufizuara për banorët e zonave rurale janë të qarta, dhe roli i grave rurale për mbijetesën e fshatrave dhe zonave rurale mbetet i padukshëm dhe i panjohur për publikun e gjerë.

Gratë nga zonat rurale japin kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e komuniteteve rurale në të gjitha rajonet, megjithatë ato përballen me më shumë kufizime sesa burrat në qasjen në burimet kryesore të prodhimit, siç janë toka dhe shërbimet, pastaj qasja në financa, e drejta e pronësisë së pronës, toka ose pajisje dhe vegla ndihmëse, nga njëra anë dhe kushtet e jetesës nga ana tjetër. Ato përballen me diskriminim për sa i përket pjesëmarrjes në tregun e punës dhe kompensimit, gjegjësisht rrogave për angazhimin e tyre në punë, punët e papaguara të shtëpisë, shkallë të ulët të përfshirjes në marrjen e vendimeve në familje etj.

Gjendja me punonjësit në vend sipas statusit ekonomik dhe gjinisë, zona rurale dhe urbane<sup>1</sup>

## GRAFIKU 1:

### Pasqyra e punonjësve sipas gjinisë dhe statusit ekonomik, në zonën rurale dhe urbane për vitin 2022



Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave për gjendjen e të punësuarve në shtet sipas statusit ekonomik dhe gjinisë, në zonat urbane dhe rurale, mund të vërehet se gratë e punësuar, punëdhënëse, të vetëpunësuar nga zonat rurale janë në numër më të vogël po të krahasohen me kategoritë e tjera. Nga ana tjetër, gratë nga zonat rurale dominojnë në grupin e punëtorëve të papaguar të familjes.

Duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e grave rurale për zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik të vendit, Enti Shtetëror i Auditimit në përputhje me Programin Vjetor të Punës për vitin 2023 kreu auditimin e performancës me temë „Barazia gjinore e grave nga zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës”.

<sup>1</sup> Burimi i të dhënave: Enti Shtetëror i Statistikës

# QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI dhe QASJA E AUDITIMIT

## QËLLIMI I AUDITIMIT

Për t'iu përgjigjur pyetjes kryesore të auditimit „**A janë efektive masat dhe projektet e ndërmarra nga institucionet kompetente në nivel qendror për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës, me qëllim pjesëmarrjen efektive në zhvillimin ekonomik dhe social të zonave rurale**”?

## FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

Identifikuam rreziqe në tri fusha dhe atë:

- Kushtet e krijuara për të siguruar barazinë gjinore të grave në zonat rurale dhe përfshirjen e tyre në tregun e punës.
- Masat e zbatuara për trajnimin profesional të grave në zonat rurale dhe për mbështetje për krijimin e vendeve të punës.
- Investimet në shërbimet publike në zonat rurale me qëllim të barazisë gjinore dhe përfshirjes së grave nga zonat rurale në tregun e punës.

---

„**A janë efektive masat dhe projektet e ndërmarra nga institucionet kompetente në nivel qendror për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës, me qëllim pjesëmarrjen efektive në zhvillimin ekonomik dhe social të zonave rurale**”?

---

## PERIUDHA E AUDITIMIT

Aktivitetet dhe masat e marra në periudhën prej vitit 2019 deri në vitin 2022, si dhe ngjarje dhe çështje të caktuara para vitit 2019 dhe më vonë deri në ditën e raportimit për auditimin e kryer.

## SUBJEKTET E PËRFSHIRA

Qeveria, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave, Agjencia për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Punësimit, Federata Kombëtare e Fermerëve dhe Enti Shtetëror i Statistikave për sigurimin e të dhënave statistikore.

## QASJA E AUDITIMIT

- Qasja e orientuar drejt sistemit
- Qasja e orientuar drejt rezultateve

## ÇKA KEMI ANALIZUAR?

Korniza strategjike dhe ligjore që kemi përfshirë me auditimin:

- Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural;
- Strategjia për Barazinë Gjinore 2013-2020 dhe 2022-2027;
- Strategjia Kombëtare për Punësim 2016-2020 dhe 2021-2027;
- Strategjia Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural 2014-2020 dhe 2021-2027;
- Programi Kombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural 2014-2020 dhe 2018-2022;
- Programet Vjetore për mbështetjen financiare të zhvillimit rural 2018-2022;
- Masat: Anëtare aktive femër në amvisërinë bujqësore, Ndihma për fermerët e rinj për fillimin me veprimtari bujqësore, Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale, Rindërtimi dhe zhvillimi i fshatrave, Ruajtja dhe avancimi i vlerave tradicionale të zonave rurale.
- Planet operative vjetore për programet dhe masat aktive për punësime dhe shërbime në tregun e punës 2019-2022;
- Programi për sigurimin social të grave që kryejnë veprimtari bujqësore për vitin 2023;
- Projekti 50 fshatra 50 tregime;
- Programi IPARD - Masa Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve.
- Programet vjetore për ndërtimin, pajisjen dhe mirëmbajtjen e objekteve për mbrojtjen e fëmijëve dhe për mbrojtjen sociale dhe shtëpive për të moshuarit 2019-2022.

## GJETJET, KONKLUZIONET dhe REKOMANDIMET KYÇE

Aktivitetet e kryera të auditimit dhe sigurimi i provave të auditimit mundësuan ta shprehim përfundimin e mëposhtëm:

- Masat dhe aktivitetet për barazi gjinore të grave nga zonat rurale nëpërmjet përfshirjes së tyre në tregun e punës që ndërmerren nga ana e institucioneve kompetente shtetërore nuk janë mjaftueshëm efikase dhe efektive me qëllim të përfshirjes së grave nga zonat rurale në tregun e punës dhe për t'i mbajtur ato në zonat rurale.
- Në strategjitë Kombëtare të Punësimit dhe Planet e Veprimit nuk parashihen synime, tregues, masa dhe aktivitete të veçanta të përshtatura për nevojat e grave nga zonat rurale për përfshirjen e tyre në tregun e punës. Gratë nga zonat rurale dhe përfshirja e tyre në tregun e punës nuk janë pjesë e prioritetëve dhe synimeve strategjike të Qeverisë.
- Të dhënat për zbatimin e planeve operative për programet dhe masat aktive për punësimin dhe shërbimet në tregun e punës nuk përmbajnë të dhëna për shfrytëzuesit e masave të ndara sipas zonave rurale dhe urbane, dhe për këtë arsye nuk mundëm ta përcaktojmë pjesëmarrjen e grave nga zonat rurale në këto programe dhe masa.
- Masat e punësimit dhe trajnimet të cilat janë realizuar gjatë periudhës së auditimit janë të përgjithshme. Ato janë të dedikuara për të gjithë burrat dhe gratë në vend, por nuk përfshijnë perspektivën gjinore dhe nuk janë përshtatur me nevojat dhe specifikat e grave në zonat rurale.
- Investimi në objektet për përkujdesje të fëmijëve për moshat parashkollore në zonat rurale paraqet bazë të mirë për ta mbajtur popullatën e re në zonat rurale. Megjithatë, konstatoam se nuk është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për nevojat e zonave rurale, afatet kohore, institucionet kompetente dhe mjetet e nevojshme financiare.
- Në vend ekzistojnë pesë institucione publike për akomodimin e personave në moshë dhe të ato janë të vendosura në zonat urbane. Strategjia për Barazi Gjinore 2021-2027 në qëllimin për përmirësimin e cilësisë së punës së grave, ka paraparë një tregues - ndërtimi i shtëpive për të moshuarit në zonat rurale. Mirëpo, nuk janë paraparë aktivitete për arritjen e qëllimit, gjegjësisht nuk është përcaktuar se sa shtëpi do të ndërtohen dhe në cilat zonat rurale.
- Nuk është e akredituar masa Investime në infrastrukturën rurale publike nga Programi IPARD, për shkak të mungesës së kapaciteteve në Agjencinë për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Kjo masë duhet të kontribuojë në përmirësimin e infrastrukturës në zonat rural dhe të kushteve për përfshirjen e grave dhe vajzave në arsim dhe tregun e punës si dhe në shërbimet shëndetësore.
- Në vitin 2019 për herë të parë u fut masa e përgjegjshme gjinore 115 – Mbështetje për anëtarin aktive grua në amvisërinë bujqësore, ndërsa në vitin 2022 u shpall edhe thirrja e dytë publike. Konstatoam se në vitin 2022 janë paraqitur 66% më pak kërkesa për mbështetje financiare në krahasim me vitin 2019, ndërsa qëndrimet dhe perceptimet e grave janë se pagesat e vonuara të mjeteve për masën e thirrjes së parë ka ndikuar në zvogëlimin e numrit të grave që kanë dorëzuar kërkesë në thirrjen e dytë.
- Në vitin 2023 është miratuar Programi për shfrytëzimin e mbështetjes financiare të pakthyeshme për gratë që kryejnë veprimtari bujqësore dhe kanë statusin e bujqve individualë të siguruar, me të cilën fitojnë të drejtën e kompensimit të lehonisë gjatë parandalimit të kryerjes së veprimtarisë bujqësore për shkak të lindjes, me çka kontribuon drejt sigurimit social të grave të cilat kryejnë veprimtari bujqësore.

- Ministria përgjegjëse (MBPEU) nuk ka kryer analizë për efektin e zbatimit të Masës 112 - Ndihma për fermerët e rinj për fillimin me një veprimtari bujqësore, gjegjësisht ndikimi i saj në forcimin, rritjen e numrit të bujqve të rinj cilët kanë filluar me veprimtari bujqësore.
- Nuk janë miratuar zgjidhje të veçanta ligjore për të mbështetur zonat plotësisht të braktisura ose zonat me shpopullim serioz në Republikën e Maqedonisë së Veriut të cilat formojnë një territor gjeografik me përmasa të konsiderueshme nga territori i përgjithshëm i shtetit (deri në 4%).



Foto: UN Women

---

„Stereotipet dhe diskriminimi duhet të eliminohen, pushteti ekzekutiv dhe legjislativ duhet të sigurojnë kushte për përfshirjen papengesë të grave rurale në tregun e punës. Ajo dëshiron, ajo mundet dhe ajo di si ta sigurojë të ardhmen e saj, të bëhet një sipërmarrëse e suksesshme, dhe të ndërtojë një të nesërme më të mirë për veten, familjen e saj dhe për progresin e përgjithshëm shoqëror”.

---

Në drejtim të tejkalimit të gjendjeve të konstatuara dhamë rekomandime deri te personat përgjegjës të institucioneve.

Theksuam nevojën për hartimin e masave të drejtpërdrejta për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës, përfshirjen e tyre në nivel kombëtar dhe lokal gjatë hartimit të masave, kryerjen e vlerësimit dhe monitorimin e efektit të masave, si dhe përcaktimin e nevojës për ndërhyrje në to. Vazhdimi i programeve dhe projekteve aktuale që mund të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të grave nga zonat rurale. Është e nevojshme të rritet numri i institucioneve për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve dhe shtëpitë e të moshuarve, si një nga parakushtet më të rëndësishme për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës, si dhe përmirësimi i shërbimeve publike për gratë nga zonat rurale (shërbimet shëndetësore, sociale, kulturore, publike, etj.) të cilat janë të nevojshme për të mbajtur popullsinë në zonat rurale dhe për të siguruar cilësinë e jetës.

Me zbatimin e rekomandimeve të dhëna pritet të jepet kontribut në përmirësimin e procesit të përfshirjes së grave nga zonat rurale në tregun e punës, dhe fuqizimin e tyre për përmirësimin dhe eliminimin e dobësive të konstatuara, mangësive në organizimin dhe funksionimin e institucioneve kompetente, me qëllim të përmirësimit të procesit të përgjithshëm në të gjitha institucionet.




# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Nga të dhënat e administruara nga AKPA konstatohet se niveli i papunësisë është më i theksuar tek gratë, banorët në zonat rurale apo personat me arsimim më të ulët etj.,

### GRAFIKU 2:

#### Të dhëna mbi punësimin e grave



Sipas këtyre të dhënave dhe të dhënave të tjera publike lidhur me këtë temë, si dhe në përputhje me Planin Vjetor të Punës, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer Auditimin e Performancës me temë **“Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale, përmes përfshirjes në tregun e punës”**. Auditimi kishte si objektiv kryesor vlerësimin e efektivitetit të politikave kombëtare të punësimit të grave në zonat rurale, duke u fokusuar kryesisht në drejtim të:

- Vlerësimin të programeve të nxitjes së punësimit nëse këto programe kanë qenë të diversifikuara dhe të përshtatura për rajone të veçanta, mbi baza gjinore;

- Vlerësimin të ofrimit të kushteve që lehtësojnë punësimin e grave nga zonat rurale, sikurse është investimi në shërbime publike, çerdhe dhe kopshte për fëmijët, apo transport nga zonat rurale në zonat urbane dhe në qendrat e punës;
- Bashkëpunimit dhe koordinimit midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive në punësimin e grave ku përfshihen edhe gratë në zonat rurale.

Për të vlerësuar politikat kombëtare të punësimit për gratë në zonat rurale ne u fokusuar në auditimin e institucioneve në nivel qendror dhe në nivel vendor.

# QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI dhe QASJA E AUDITIMIT

## QËLLIMI I AUDITIMIT

Të vlerësojë nëse politikat kombëtare të punësimit përfshijnë punësimin e grave nga zonat rurale.

## PERIUDHA E AUDITIMIT

2019 - 2023

## SUBJEKTET E AUDITIMIT

- Institucione në nivel qendror:
  - Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
- Institucione në nivel vendor:
  - 13 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore (Bashkitë Shkodër, Kukës, Lezhë, Dibër, Krujë, Elbasan, Kavajë, Divjakë, Lushnje, Berat, Pogradec, Vlorë, Gjirokastër)..

## QASJA E AUDITIMIT

- Qasje e orientuar drejt problemit (Qasje e auditimit e bazuar në risk);
- Qasje e orientuar drejt rezultateve.

## BAZA LIGJORE DHE KUADRI RREGULLATIV KRYESOR QË U PËRDOR PËR TË VLERËSUAR AKTIVITETIN E SUBJEKTEVE (BURIMI I KRITEREVE TË AUDITIMIT)

- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022;
- Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020”;
- Strategjitë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020/2021-2030;
- Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 15/2019 datë 13.03.2019 ”Për nxitjen e punësimit”;



Foto: UN Women

- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Programet kombëtare të punësimit të miratuara në vitin 2020.

## FUSHAT E AUDITUARA

- Programet e nxitjes së punësimit;
- Investimet e kryera nga qeverisja qendrore dhe ajo vendore në përmirësimin e infrastrukturës që mbështet punësimin e grave rurale;
- Bashkëpunimi midis institucioneve qendrore dhe vendore për të kontribuar në punësimin e grave nga zonat rurale;
- Monitorimi i zbatimit të politikave të punësimit.

13

Bashki të  
audituar

116

Njësi  
administrative

18

Njësi  
administrative  
kanë çerdhe

108

Njësi  
administrative  
kanë kopshte

## GJETJET, KONKLuzionET dhe REKOMANDIMET KYÇE

Në përfundim të auditimit, pas analizimit të të gjitha të dhënave të mbledhura dhe pas marrjes së komenteve nga subjektet e audituara, grupi i auditimit përfundoi me gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit si më poshtë:

- Programet e nxitjes së punësimit të zbatuara nga AKPA për vitet 2020-2023 janë të përgjithshme, nuk kanë në fokus gratë dhe në veçanti gratë në zonat rurale. Këto programe parashikohet të zbatohen në të gjithë vendin dhe fokusohen te grupet vulnerabël, por nuk evidentohet se sa janë të zbatueshme në zonat rurale.
- Ka më shumë punëkërkes të papunë të regjistruar në zonat rurale sesa në zonat urbane. Raporti i papunësisë së grave të regjistruara në zonat rurale është 53,6 % e totalit dhe 7,4 % e tyre janë kryefamiljare.
- Të gjitha bashkitë e audituara nuk sigurojnë shpërndarje të barabartë të çerdheve dhe kopshteve ndërmjet zonave rurale dhe urbane, duke treguar më së shumti mungesën e çerdheve.
- Shërbimet e punësimit të ofruara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive nuk janë plotësisht të bashkërenduara me njësitet e vetëqeverisjes vendore. Komunikimi midis strukturave qendrore dhe vendore nuk identifikon nevojat e grave në përgjithësi dhe grave rurale në veçanti.
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive edhe pse e ka monitoruar periodikisht zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara për t'u realizuar me qëllim arritjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019-2022, nuk konstatohet se si janë përdorur konkretisht rezultatet e monitorimit për të përmirësuar politikën e punësimit, apo cilat janë përmirësimet specifike që janë bërë në referencë të rezultateve të monitorimit.
- Qasja e grave në tregun e punës dhe puna e denjë janë elementë shumë të rëndësishëm për të mbështetur fuqizimin ekonomik të tyre, por të dhënat në lidhje me programet e nxitjes së punësimit nuk tregojnë ndonjë masë të marrë për punësimin e grave rurale.
- Aktualisht, edhe pse ka një bashkëpunim mes Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe bashkive, nuk mund të themi se ofrohen shërbime efektive për punëkërkesit, përfshirë gratë rurale. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, nuk adreson problemet që pengojnë gratë rurale të jenë pjesë e tregut të punës.
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive duhet të fokusohet në nevojat reale të grave në zonat rurale për të ofruar shërbime të programeve të punësimit, shërbime trajnimi dhe sisteme informacioni për tregun.
- Njësitet e Vetëqeverisjes Vendore, në përputhje me strategjitë e tyre rajonale për zhvillimin e zonave rurale, duhet të marrin masa për vlerësimin e nevojave për çerdhe dhe kopshte në territorin e tyre dhe më pas të hartojnë plane specifike investimi.
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive në bashkëpunim me Njësitet e Vetëqeverisjes Vendore duhet të marrin masa për identifikimin e nevojave të grave rurale për rritjen e pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës, si dhe të planifikojnë fonde për financimin e programeve për nxitjen e punësimit të tyre.
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive duhet të analizojë rezultatet e monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe të ndërmarrë aktivitete specifike që adresojnë problemet e theksuara nga këto rezultate monitorimi.

# ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT TË KOSOVËS

Për më shumë se dy dekada Kosova është përballur me papunësinë e madhe në zonat rurale, ku veçanërisht preken gratë. Për të arritur uljen e papunësisë në këto zona dhe përmirësimin e jetës së grave, janë paraparë grante qeveritare të cilat shpërndahen përmes programit të zhvillimit të bujqësisë. Për të vlerësuar ndikimin e këtyre granteve, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës ka kryer një auditim të performancës, duke ofruar një analizë gjithëpërfshirëse të arritjeve, sfidave dhe pengesave të hasura në përfshirjen e grave rurale në fuqinë punëtore të Kosovës. Ky raport synon të fuqizojë gratë rurale në shtetin e Kosovës dhe të rrisë përfshirjen e tyre në tregun e punës.

## SUBJEKTI I AUDITIMIT

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”.

Auditimi i performancës ka për qëllim vlerësimin e efektivitetit dhe ndikimin e politikave, programeve dhe masave që synojnë nxitjen e përfshirjes së grave nga zonat rurale në tregun e punës, me fokus identifikimin e mundësive për përmirësim.

Auditimi i performancës ka përfshirë subjektet e mëposhtme: Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Agjencinë e Zhvillimit të Bujqësisë (AZHB), si dhe Agjencinë e Punësimit (AP), me fokus të veçantë Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, kryesisht të dy masave si në vijim:

### MASA 1

Investimet në pasuritë fizike në ekonomitë bujqësore- përqendrohet në përkrahjen e investimeve në këta sektorë: pemë, perime (përfshirë patatet), qumësht, mish, rrush dhe vezë.

### MASA 2

Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit - mbështetë një varg aktivitete bujqësore dhe jo-bujqësore përmes sektorëve siç janë: artizanalet, zhvillimi i turizmit rural, prodhimtaria e mjaltit, produktet jo drusore, akuakultura dhe rritja e shpezëve.

Përzgjedhja e këtyre dy masave është bërë për faktin se përmes tyre, gratë fermere kanë përparësi në përfitimin e granteve investive duke u vlerësuar me pika shtesë.



Foto: Freepik

# QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI dhe QASJA E AUDITIMIT

## QËLLIMI I AUDITIMIT

Objektivë e këtij auditimi është që të vlerësojmë efektivitetin dhe ndikimin e politikave, programeve dhe masave që synojnë promovimin e përfshirjes së grave nga zonat rurale në tregun e punës, me fokus në rritjen e pjesëmarrjes së tyre dhe identifikimin e mundësive për përmirësim.

## PERIUDHA E AUDITIMIT

- Auditimi ka përfshirë periudhën 2019 - 2023
- Duke u fokusuar në ndikimin e programeve dhe masave për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës.

## SUBJEKTET E PËRFSHIRA

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë
- Agjencia e Punësimit

## QASJA E AUDITIMIT


Auditimi është zhvilluar sipas qasjes së bazuar në rezultate dhe qasjen e bazuar në problem auditues, me qëllim kryesorë që të vlerësoj shpërndarjen e granteve për grate në zonat rurale.

## KORNIZA LIGJORE PËR BARAZINË GJINORE

- Ligji për barazi gjinore
- Ligji në Agjencinë e punësimit në Republikën e Kosovës
- Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
- Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim të vendeve rurale 2022-2028
- Programi për zhvillim rural 2022
- Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020
- Programi për Zhvillim Rural 2020-2021

## FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

- Niveli i zbatimit të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bazuar në kuadrin strategjik dhe ligjor, duke u përqendruar kryesisht në dy masa, ku gratë fermere kanë përparësi të përfitimi.
- Institucioni përgjegjës për zbatimin e Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2020, përfshirë programet vjetore 2019, 2020-2021, 2022 dhe 2023.
- Monitorimi i arritjes së qëllimeve, vlerësimi dhe raportimi i Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2020 duke përfshirë programet vjetore 2019, 2020-2021, dhe 2022



## GJETJET, KONKLuzionET dhe REKOMANDIMET KYÇE


Bazuar në aktivitetet e kryera të auditimit dhe dëshmitë e mbledhura, kemi ardhur në gjetjet dhe konkluzionet si vijon:

**Masat aktuale afirmative nuk janë efektive për të mbështetur gratë në zonat rurale.** Kushtëzimi i masës afirmative me tre deri në pesë vite si pronare e tokës apo e biznesit, e ka bërë të pa efektshëm qëllimin e tyre për shkak se kufizon pjesëmarrjen apo përkrahjen e grave dhe vajzave të cilat kanë filluar aktivitetin e tyre rishtazi. Meqenëse problemet e pronësisë janë dukshëm më të shprehura te gjinia femërore, mos zbatimi i masës afirmative rrit numrin e të refuzuarave nga gjinia femërore. Po ashtu, kriteret e përzgjedhjes nuk sigurojnë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e barabartë të gjinisë femërore në përfitimin e granteve përmes programit për zhvillim rural. Kriteret e përzgjedhjes me bazë gjinore implikohen nga kriteret tjera duke ndikuar negativisht në nivelin e grave përfituese.

Në grafikët e mëposhtëm kemi paraqitur situatën aktuale për të dyja masat.

**GRAFIKU 3:**


**Numri i aplikuesve dhe përfituesve sipas gjinisë**



Për Masën “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve” gjatë vitit 2019, 54.4% e përfituesve kanë qenë gra, kurse 45.6% burra. Në vitin 2020/21 numri i përfituesve gra ka shënuar një rënie të lehtë, kurse është rritur numri i përfituesve burra dhe ka arritur shkallën 50:50. Përderisa, në vitin 2022 numri i përfituesve gra ka vazhduar të shënoj rënie duke arritur në 44.3%, kurse burrat duke shënuar ngritje dhe arritur në 55.7%.

**GRAFIKU 4:**

**Raporti mes aplikuesve/përfituesve të gjinisë femërore**



Niveli i lartë i grave aplikuese qëndron në raport të zhdrejtë me nivelin e përfituesve, pavarësisht rritjes së numrit të aplikanteve. Kjo tregon se, niveli i grave përfituese ka rënë për masën “Investime në asete fizike në ekonomitë bujqësore”.

**Programet për Zhvillim Rural nuk janë hartuar dhe aprovuar me kohë.** Vonesat në hartimin dhe aprovimin e Programeve kanë ndikuar në mënyrë zingjirore edhe në vonesa tjera siç janë: vonesa në shpalljen e thirrjeve për aplikim si dhe në përzgjedhjen e përfituesve të granteve. Të gjitha thirrjet për aplikim për fermerë dhe ekonomi familjare gjatë periudhës 2019-2022 janë bërë në pjesën e dytë të vitit, ndërsa shpallja për vitin 2023 është bërë në fund të këtij viti.

**Janë identifikuar mangësi në monitorim dhe mbikëqyrje për përfituesit e granteve.** Mungesa e funksionimit të Komitetit Monitorues që nga viti 2014 dhe trajtimit të duhur të raporteve të monitorimit ka rezultuar në mungesë të të dhënave për të pasqyruar rezultatet e arritura apo ndikim-

in e tyre në përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës. Në raportet e monitorimit mungojnë të dhënat e ndara sipas gjinisë, rotacioni i inspektorëve nuk është kryer vazhdimisht në mënyrën e duhur, kriteret për punonjësit apo hapja e vendeve të reja të punës nuk janë verifikuar siç është parashikuar në projekt.

**Mangësitë e informacionit dhe pengesat e komunikimit.** Autoriteti Menaxhues në bashkëpunim me Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për informimin e fermerëve për mbajtjen e sesioneve informuese për Programin e Zhvillimit Rural, por numri i pjesëmarrësve, veçanërisht i grave, nuk është i kënaqshëm.

Mungesa e informacionit specifik gjinor të aplikuesve për grante ka ndikim negativ në politikëbërje. Dështimi për të informuar gratë në zonat rurale lidhur me mundësinë e përfitimit të granteve rezulton në një nivel të ulët të përfshirjes së tyre.

| Viti | Numri i pjesëmarrësve | Gra | Burra |
|------|-----------------------|-----|-------|
| 2019 | 789                   | 93  | 696   |
| 2022 | 213                   | 27  | 186   |

Nga tabela mund të vërehet se në sesionet informuese të mbajtura në vitin 2019 dhe 2022, numri i grave është dukshëm më i ultë në krahasim me numrin e burrave. Në vitin 2019, rreth 12% e pjesëmarrësve kanë qenë gra, kurse 88% burra. Përderisa, në vitin 2022 rreth 13% e pjesëmarrësve kanë qenë gra dhe 87% burra. Pjesëmarrja e ultë e grave mund të ketë ndodhur si shkak se sesionet informuese mbahen vetëm gjatë periudhës kur bëhet shpallja e thirrjeve për aplikim, e nuk mbahen takime të rregullta me grupet e synuara gjatë tërë vitit.

**Agjencia e punësimit nuk posedon të dhëna të ndara në baza gjinore, sipas zonave urbane dhe rurale.** Agjencia e Punësimit nuk ka një pasqyrë të qartë për gjendjen dhe nevojat e grave nga zonat rurale. Mungesa e këtyre të dhënave ka një efekt në paqartësi për grupet e interest në aspektin e njohjes së nevojave dhe planifikimin e zgjerimit të tregut në favor të barazisë gjinore. Kurse dështimi për të komunikuar në mënyrë efektive informacionin, veçanërisht në lidhje me trajnimin profesional për gratë fermere, kufizon përfshirjen e tyre në tregun e punës.


Situata e lartpërmendur tregon se edhe pse institucionet publike përgjegjëse kanë ndërmarrë një sërë veprimesh për të forcuar pozitën e gruas në shoqëri, ende nuk janë arritur rezultate të kënaqshme për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës.

Programet e Zhvillimit Rural dhe masat afirmative nuk kanë arritur të sigurojnë një përkrahje të barabartë për të dy gjinitë dhe nuk ka një vlerësim rreth arritjes së qëllimeve të programit nga perspektiva gjinore. Masat afirmative kushtëzojnë gratë me tre deri në pesë vite si pronare e tokës apo e biznesit, duke e bërë të pa efektshëm qëllimin e tyre, për shkak se kufizon pjesëmarrjen apo përkrahjen e grave dhe vajzave të cilat kanë filluar aktivitetin e tyre rishtazi. Mungon një aktivizim më i madh në informimin e duhur të grave për shfrytëzimin e të drejtës së tyre të garantuar me ligj. Përderisa, mungesa e funksionalizimit të Komitetit Monitorues, ka shkaktuar probleme në procesin e monitorimit të programeve për Zhvillim Rural dhe si rrjedhojë nuk kanë të dhëna për të pasqyruar rezultatet e arritura apo ndikimin e tyre në përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës, arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Agjencia e Punësimit nuk posedon të dhëna të ndara sipas gjinisë për zonat urbane dhe rurale në lidhje me regjistrimin, shërbimet e punësimit, pjesëmarrjen në masat aktive të tregut të punës dhe aftësimin profesional të të papunëve të regjistruar. Në veçanti, mungesa e shërbimeve për aftësimin profesional të grave fermere bën që kjo kategori të ketë vështirësi në përfshirjen e tyre në tregun e punës.

Zbatimi i rekomandimeve të dhëna pritet të përmirësojë ndikimin e politikave, programeve dhe masave që synojnë promovimin e përfshirjes së grave nga zonat rurale në tregun e punës.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë janë pajtuar pjesërisht me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, komentet i janë bashkëngjitur raportit, si dhe janë zotuar se do t'i adresojnë të gjitha rekomandimet e dhëna. Poashtu, edhe Agjencioni i Punës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit dhe janë zotuar se se do t'i adresojnë të gjitha rekomandimet e dhëna.



Kjo broshurë është zhvilluar në kuadër të projekteve të UN Women "Financimi transformues për barazinë gjinore drejt një qeverisjeje më transparente, gjithëpërfshirëse dhe llogaridhënëse në Ballkanin Perëndimor" financuar nga Suedia, projekti "Promovimi i politikave dhe buxheteve të përgjegjshme gjinore: drejt qeverisjes transparente, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut - Faza 2" financuar nga Zvicra dhe programi "Promovimi i menaxhimit me përgjegjësi gjinore në Republikën e Maqedonisë së Veriut" i financuar nga Suedia.

Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë mendime dhe qëndrime të autorëve dhe nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet dhe qëndrimet e UN Women, Kombeve të Bashkuara ose organizatave tjera shoqëruese, ose Suedisë dhe Zvicrës si donatorë.